



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 331/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të mbulimit dhe dëmtimit të posterave, në seancën e panelit të mbajtur me 08.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET ankesa si e bazuar.

Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3300 (tremijetreqind) euro, të cilën detyrohet të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) dite nga dita e pranimit të këtij vendimi, për tu dërguar pastaj në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Subjekti politik AKR, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, duke i mbuluar posterat e subjektit politik AKR, me posterat e kandidatit të tyre për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës, Hashim Dëshishku.

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 06.12.2010, nga subjekti politik AKR, në të cilën theksohet se subjekti politik LDK ia ka mbuluar posterat e subjektit politik AKR, me posterat e kandidatit për deputet në Parlamentin e Kosovës, Hashim Dëshishku e që është në kundërshtim me nenin 33 pika (a) të LZP-së dhe Rregullës Zgjedhore Nr.11/09 neni 3 paragrafi 1 pika (a), *Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët*.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi si dëshmi, në të cilën shihet qartë se posterit i kandidatit Hashim Dëshishku nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur mbi posterat e subjektit politik AKR. Parashtruesi i ankesës propozon që të ndërmerren masat e parapara ligjore.

Në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it:

PZAP-i e informoi subjektin politik LDK, më datë 06.12.2010, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 07.12.2010, gjerë në ora 16:00. PZAP-i, pranoi përgjigjeje në ankesë nga subjekti politik LDK, sipas afatit të caktuar. Në përgjigjeje të ankesës theksohet se vendosja e posterit të subjektit politik LDK, mbi posterin e AKR-së nuk është e sqaruar qartë nga ankesa e parashtruar. Sipas përgjigjejes në ankesë ky subjekt politik i ka njoftuar anëtarët dhe simpatizant për rregullat ligjore për vendosjen e posterave dhe njëkohësisht shpreh keqardhja për atë që ka ndodhur.

Përgjigjëses në ankesë subjekti politik LDK nuk i ka bashkangjitur asnjë provë që tregon se ky subjekt politik ka bërë përpjekje serioze për të parandaluar shkeljen e këtij Kodi.

Veprimet e Ndaluar të Subjekteve Politike

Dispozita ligjore e Nenit 33 pika (a) i LZP-së dhe neni 3 paragrafi 1 pika (a) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, parashohin se:

Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim:

a) heqja, mbulimi, dëmtimi ose ndryshimi i ndonjë njoftimi, pllakati, posteri ose materiali tjetër i cili përdoret për qëllime të fushatës zgjedhore nga ana e një subjekti tjetër politik;

Përmirësimet dhe sanksionet ndaj shkeljeve

Neni 120 paragrafi 1 pika (c) i LZP-së, parasheh se:

Në rast se PZAP-i përcakton se ka ndodhur shkelje e këtij ose rregullave të KQZ-së, mund të:

c) të vendos një gjobë ndaj një subjekti politik në vlerë deri pesëdhjetëmijë Euro (€50,000).

Gjatë përcaktimit të vlerës së gjobës ndaj subjekti politik për ndonjë shkelje, PZAP-i ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë;
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Përgjegjësit e Subjekteve Politike, Mbështetësve të tyre dhe Kandidatëve, parashihen në; Nenin 32 paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7, të LZP-së.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se posteri i kandidatit për deputet në Parlamentin e Republikës së Kosovës Hashim Deshishku, nga radhët e subjektit politik LDK, është vendosur mbi posterin e subjektit politik AKR. Prandaj nga arsyet lartcekura e më qëllim të evitimit të shkeljeve të potencuar më lartë dhe në pajtim më dispozitat e lartcekura ligjore, PZAP-i vlerëson se ankesa është e bazuar, e lidhur me nenin 115.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 331/2010 më datën 08.12.2010

